

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Ky projektligj nuk përafron legjislacionin e BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësinë 2014-2024
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	16-11-2018 &...
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	29.10.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 –MBZHR-Nr.2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, Mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit: Luljeta Çuko e-mail-i: luljeta.cuko@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0684681827 Entela Kola e-mail-i: entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Glaudjana Musaj e-mail— i: glaudiana.musaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688846379
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i>	

Incidentet e ndodhura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, të cilat kanë lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike apo edhe të lëndëve mbetëse të dëmshme, të cilat gjenden në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangte në një nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande dhe raportimi është i shkëputur për shkak të fragmentizimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore.

Unifikimi i zinxhirit të komandës në linjë vertikale, duke bërë të mundur kryerjen e funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit vendor nga shërbimi veterinar rajonal, plotëson detyrimet që Shqipëria ka drejt përmbushjes së kritereve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, të cilat janë rekomandime të vazhdueshme të dhëna në Raportin e Progresit të Komisionit Europian por edhe detyrimet si anëtare të OIE (World Organisation for Animal Health), ku gjatë misionit të saj në vitin 2014 në Shqipëri, për vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave të shërbimit veterinar, rekomandoi se “...është e një rëndësie kritike rishikimi i roleve dhe përgjegjësi të Ministrisë së Brendshme-Veterinerëve të Bashkive; duke konsideruar shumë të rëndësishëm transferimin e tyre në Shërbimin Veterinar Shtetëror pasi sigurohet kapaciteti teknik dhe menaxhues i Shërbimit Veterinar Shtetëror”.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Unifikimi i shërbimit veterinar brenda vitit 2021, që lidhet me një organizim të mirë të shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies.
- Garantimi i gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore nëpërmjet identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale dhe tufave bazë nga viti 2022.
- Garantimi i mbrojtjes së shëndetit të kafshëve nga sëmundjet me karakter zoonotik nëpërmjet kryerjes në mënyrë efikase të masave të profilaksisë specifike.
- Garantimi i sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga kontrolli korrekt dhe me përgjegjësi të lartë të therjeve të kafshëve në thertore.
- Regjistrimin e të gjitha llojeve të kafshëve që mbarështohen në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim planifikimin korrekt të masave profilaktike.
- Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve nëpërmjet disiplinimit të lëvizjeve të kafshëve në territorin e vendit.
- Lehtësimi i biznesit nga procedura të panevojshme burokratike duke përmirësuar praktikën për regjistrimin e PMV-ve.
- Garantimi i një niveli më të lartë të sigurisë ushqimore nëpërmjet monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe mjedis.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- Opsioni 0 (status quo): nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.
- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
- Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik (shërbimi veterinar rajonal, procesi i monitorimit) me një vlerë prej 176 milion lekë si rezultat i transferimit të funksioneve nga pushteti vendor në shërbimin veterinar rajonal e cila kërkon një shtesë prej 400 veterinerë zyrtarë. Gjithashtu, shtesa në Buxhetin e Shtetit do të përfshijë edhe 48 milion lekë për investime fillestare. Kostot e përhershme janë në vlerën 309,945 mijë lekë vjetore. Nga ana tjetër, reduktimi i transmetimit të sëmundjeve si rezultat i rritjes së kontrollit të lëvizjes së kafshëve, rritjes së biosigurisë në fermë dhe tregtimit të kafshëve në tregje të miratuara dhe kontrolluara reduktojnë shpenzimet për mjekimin e kafshëve si dhe dëmin ekonomik për subjektet të shkakuar nga ngordhja e tyre.

Do të ketë gjithashtu edhe disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në formalizimin e subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e mbarështimit dhe tregtimit të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore si dhe rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që aktualisht zhvillojnë aktivitetin në këtë fushë si rezultat i forcimit të kontrollit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore të cilat kanë një risk të lartë në shëndetin e njeriut, e si pasojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor, reduktohen.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë është unifikimi i shërbimit veterinar e cila çon në forcimin e kontrollit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve gjatë të gjithë stadeve të jetës së tyre e cila ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve nga sëmundjet zoonotike si dhe mbrojtjen e mjedisit nga prodhimi, përpunimi, ruajtja, transporti dhe tregtimi i produkteve me origjinë shtazore për konsum njerëzor ose

jo si dhe duke zbatuar masat e biosigurisë në fermë.

Ky ligj zbatohet për operatorët e biznesit që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj dhe miratimi i këtij ligji do të çojë në uljen deri në reduktim të informalitetit në këtë fushë. Numri i subjekteve që zhvillojnë veprimtarinë në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve do të rritet dhe licencimi i këtyre veprimtarive që kërkon pajisjen me lejen e mjedisit për secilin subjekt që ushtron aktivitetin, para licencimit. Është kusht që për subjektet të cilët do të zhvillojnë aktivitetin e mbarështimit të kafshëve, tregtimit të tyre, tregtimit të nënprodukteve me origjinë shtazore si dhe të tregtimit me shumicë të produkteve mjekësore veterinarë, përpara miratimit të licencimit duhet të paraqesin lejen e mjedisit. Për sa më sipër ndikimi në mjedis do të jetë pozitiv.

Ndikimi Social i drejtpërdrejtë. Transferimi i funksioneve të shërbimit veterinar nga pushteti vendor në shërbimin veterinar rajonal kërkon shtimin e numrit të veterinerëve zyrtar. Për përmbushjen e kësaj politike të re, për të afruar shërbimin veterinar sa më pranë fermerit dhe duke rritur garancinë për ushqim të sigurtë si rezultat i kafshëve të shëndetshme, do të punësohen rreth 400 veterinerë ose 2.3 herë më shumë se numri aktual i tyre.

Zbatimi me korrektësi i masave profilaktike shtetërore do të ndikojë në rritjen e numrit të krerëve të bagëtive dhe në rritjen e shitjeve të produkteve blegtorale duke pasur një impakt pozitiv në rritjen e të ardhurave të tyre. Aktualisht këto masa profilaktike aplikohen vetëm në fermat me 10 krerë e lart. Miratimi i këtij projektligji do të bëjë të mundur zbatimin e tyre edhe në fermat me një kafshë të vetme të çdo lloji.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë do të ketë edhe tek konsumatori për produkte ushqimore më të sigurt dhe cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie.

Rritja e sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore do të ndikojë në rritjen e shkallës së besueshmërisë të konsumatori.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opcionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Me ligjin aktual situata është parë që nuk do sillte përmirësime sa i takon koordinimit ndërinstitutional dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësiave mes aktorëve të përfshirë në proces, gjë që do të çonte në humbje të popullatës së kafshëve në Shqipëri, në mungesën e një sistemi të mirëfilltë kontrolli të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si pasojë do të kemi paaftësi në marrjen e masave të duhura profilaktike për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët tek njeriu. Gjithashtu nuk do të arrinim përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të BE-së dhe OIE-së, për krijimin e një linje vertikale komande dhe raportimi në shërbimin veterinar shqiptar..

Pas analizës së kryer rezultoi se zgjidhja e problematikave të cituara më lart, në fushën e shërbimit veterinar, realizohet nëpërmjet ndryshimeve në ligjin aktual. Hartimi i një ligji të ri nuk është i nevojshëm pasi nuk do të sillte asgjë të re si dhe do të kërkonte më shumë kohë për hartimin dhe miratimin e tij, gjë e cila do shoqërohej me kosto më të lartë.

Kostoja e përlllogaritur në total e opcionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë

periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
358,745,000	309,945,000	309,945,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar)?, (çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse)?

Ndryshimet ligjore në shërbimin veterinar janë pjesë e reformës së shërbimit veterinar dhe unifikimit të strukturës veterinarë të njërive të qeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar e mbështetur nga Bashkimi Evropian (Delegacioni Evropian në Shqipëri). Kjo reformë është lançuar në 16 tetor 2015 nga MBZHRAU, në një takim me prezencën e Zëvendëskryeministrit dhe Ambasadores së Bashkimit Evropian në Shqipëri. Janë zhvilluar një sërë takimesh konsultative të grupit të punës me ekspertë të Projektit PAZA në të cilat janë diskutuar nenet e lidhura me përgjegjësitë e shërbimit veterinar rajonal në lidhje me funksionet kontrolluese dhe të shërbimit si dhe fushat e përgjegjësisë së shërbimit veterinar rajonal dhe të shërbimit veterinar pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Sugjerimet janë pasqyruar në projektligj. Konsultime janë zhvilluar me drejtues të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe mendimet e tyre janë reflektuar në projektligj duke parashikuar që AKU, në raste të konstatuar ose të dyshimta për mospërputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe që shkak mund të jetë kafsha e gjallë, për të vlerësuar shkakun e origjinës, mund të kryejë gjurmin në fermën e kafshëve të gjalla. Në këtë rast, shërbimi veterinar rajonal mbështet AKU-në. Gjithashtu, janë pasqyruar edhe sugjerimet në lidhje me kalimin e plotë të kompetencave në kontroll dhe vendimmarrje në PIK për ngarkesat me kafshë të gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor që importohen, eksportohen ose tranzitohen në territorin e Republikës së Shqipërisë duke riformuluar nenin përkatës për t'ia kaluar këtë kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i cili është autoriteti përgjegjës për pikat e inspektimit kufitar. Konsultime janë zhvilluar edhe me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ku janë diskutuar transferimi i funksioneve nga njësitet e vetëqeverisjes vendore në shërbimin veterinar rajonal. Sugjerimi për përcaktimin me Vendim të Këshillit të Ministrave të detyrave dhe bashkëpunimit në zbatim të ligjit për vetëqeverisjen vendore është pasqyruar në projektligj.

Më datë 16.11.2018 është zhvilluar një takim konsultativ me të gjitha grupet e interesit. Të pranishëm kanë qenë përfaqësues nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, stacionet veterinarë, farmacistë veterinar, fermerë, veterinerë zyrtar dhe privat. Janë diskutuar të gjitha ndryshimet e propozuara në projektligj si dhe janë marrë në konsideratë sugjerimet e bëra. Gjithashtu, nën drejtimin e ministrit të Bujqësisë, janë zhvilluar dy takime me Bordin Strategjik të Ministrisë së Bujqësisë ku janë diskutuar nenet e ndryshuara të propozuara në këtë projektligj dhe struktura e shërbimit veterinar.

Ky projektligj si dhe vlerësimi i ndikimit janë publikuar në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik <http://www.konsultimipublik.gov.al/>

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit në lidhje me kontrollin e kryerjes së masave profilaktike për çrënjosjen e sëmundjeve zoonotike, kontrollin e lëvizjes së kafshëve dhe do të plotësohet me miratimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji. Citojmë se që në vitin e parë të zbatimit të ligjit do të hartohen aktet nënligjore që lidhen me programet e çrënjosjes së sëmundjeve të brucelozës, tuberkulozit, plasjes si dhe dermatozës nodulare të gjedhit.

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, janë:

- a) Drejtoria përgjegjëse për veterinarinë në ministri;
- b) Shërbimi veterinar pranë Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve në 4 rajonet (ARSHVMB);
- c) Komisioni Shtetëror i regjistrimit të produkteve mjekësore veterinare;
- d) Laboratori kombëtar i referencës (ISUV), dhe laboratorët e miratuar të kontrollit;
- e) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Drejtoria përgjegjëse për veterinarinë në ministri harton politikën, aktet nënligjore si dhe strategjitë përkatëse për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve të gjalla, programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë të cilat zbatohen nga shërbimi veterinar pranë ARSHVMB-ve, në të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtarinë brenda fushës së veprimit të këtij ligji si dhe laboratorit kombëtar i referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Gjatë zbatimit ndër vite të Ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë vënë re disa mangësi të cilat ndikonin në mënyrë të drejtëpërdrejtë në garantimin e jetës dhe shëndetit të kafshëve e më pas në garantimin e sigurisë ushqimore. Sipas këtij ligji, shërbimi veterinar përbëhej nga veterinerët zyrtarë pranë drejtorive të bujqësisë, veterinerët e njësive të vetëqeverisjes vendore, veterinerët autonomë dhe veterinerët pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU). Duke qenë shumë institucione të përfshira në shërbimin veterinar, dhe mos ndarjes qartë të detyrave dhe kompetencave, duke u shkëputur zinxhiri vertikal i komandës dhe raportimit, shpesh herë kishte hallka që mbivendoseshin njëra me tjetrën ose krijonin boshllëqe. Mangësitë e vërejtura ndër vite gjatë zbatimit të këtij ligji në fushën e shëndetit të kafshëve dhe të njerëzve treguan se kishte shkëputje të zinxhirit komandues për shkak të fragmentizimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe vetëqeverisjes vendore. Përveç të tjerash, për përmbushjen e detyrave të përcaktuara nga ky ligj, numri i mjekëve veterinarë (veteriner zyrtar) ishte i pamjaftueshëm (rreth 166 mjekë veterinarë të angazhuar në të gjitha

strukturat). Për të shmangur fragmentizimin e shërbimit veterinar, dhe për të plotësuar boshllëqet në këtë shërbim parashikohet shtimi i mjekëve veterinerë shtetëror në rreth 2.3 herë më shumë. Nga analiza e vlerësimit të zbatimit të dispozitave të parashikuara nga ky ligj rezultoi se ka mangësi në kryerjen e masave profilaktike, të kontrollit të therjeve të kafshëve në thertore, mungesë të regjistrimit të kafshëve dhe çregjistrimit të tyre pas therjes apo ngordhjes, si dhe probleme në kontrollin e lëvizjes së kafshëve. Gjithashtu, kryerja e masave profilaktike varej nga angazhimi i stacioneve veterinarë për të marrë pjesë në procedurat e tenderimit. Me ndryshimet e propozuara parashikohet thjeshtimi i strukturës së institucioneve të kontrollit, monitorimit dhe shërbimeve veterinarë. Kjo do të sjellë unifikimin e shërbimit veterinar, aktualisht i fragmentuar në atë të shërbimit veterinar në strukturat e MBZHR dhe në atë të njërive të vetëqeverisjes vendore duke bërë të mundur zinxhirin efikas të shërbimeve veterinarë pa krijuar asnjë boshllëk. Gjithashtu, do të garantohet përmirësimi i regjistrimit të PMV dhe kontrollit më të mirë të biosigurisë në fermat e mbarështimit të kafshëve dhe monitorim më efikas të mbetjeve të antibiotikëve dhe të lëndëve kimike në mjedis.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Mangesitë e vërejtura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, të cilat kanë lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike (bruceloze, tuberkuloz, antraks, etj) apo edhe të lëndëve mbetëse të dëmshme të cilat gjenden në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangte në një nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande është i shpërbur për shkak të fragmentizimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Për këtë qëllim ky projektligj parashikon unifikimin e zinxhirit të komandës në linjë vertikale duke bërë të mundur kryerjen e funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit vendor nga shërbimi veterinar rajonal. Në këtë mënyrë plotësohet edhe rekomandimi i vazhdueshëm i dhënë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian si dhe të misionit të OIE-së, në vitin 2014 në Shqipëri, për vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave të shërbimit veterinar, i cili rekomandoi se “është i një rëndësie kritike rishikimi i roleve dhe përgjegjësisë të Ministrisë së Brendshme-Veterinere të Bashkive; duke konsideruar shumë të rëndësishëm transferimin e tyre në Shërbimin Veterinar Shtetëror pasi sigurohet kapaciteti teknik dhe menaxhues i Shërbimit Veterinar Shtetëror”.

Problemet hasen në kryerjen e masave profilaktike me qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të kafshëve, garantimit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së mjedisit. Shumë të rëndësishme janë masat profilaktike ndaj sëmundjeve zoonotike të transmetueshme tek njeriu si bruceloza dhe tuberkulozi. Lëvizja e kafshëve të gjalla dhe tregtimi i tyre në tregun e

kafshëve të gjalla, e cila është njësi epidemiologjike, janë burim kryesor i transmetimit dhe përhapjes së sëmundjeve nëse nuk përfshihen në kontrollin brenda standardeve të zinxhirit të kontrollit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Gjithashtu është shumë e rëndësishme forcimi i kontrollit të therjes së kafshëve nëpërmjet kalimit të kontrollit shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes. Për këtë qëllim projektligji parashikon që kontrolli para dhe pas therjes si dhe kontrolli i tregjeve të kafshëve të gjalla të përfshihet në detyrat e veterinerit zyrtar të shërbimit veterinar rajonal. Për herë të parë, në zbatim të rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, projektligji parashikon zbatimin e masave për biosigurinë në ferma me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë dhe/ose objekt, në zonat ose çdo ambient tjetër dhe mjetet e transportit”.

Vlerësimi i punës së tyre në lidhje me detyrat e deleguara, rezulton se kryerja e masave profilaktike shtetërore, identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve nuk garantohej sipas standardeve dhe strategjive në fuqi në një masë të konsiderueshme. Për këtë qëllim projektligji parashikon kryerjen e shërbimeve në shëndetin e kafshëve nga shërbimi veterinar rajonal. Veterinerët zyrtar që do të kryejnë këto funksione do të jenë më afër fermerit, në çdo njësi administrative, përgjegjës për ofrimin e shërbimit në zbatim të strategjive për sëmundje të ndryshme, mbajtjen nën kontroll të situatës epizootike si dhe të lëvizjes së kafshëve në njësinë ku është përgjegjës. Me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore nga ferma në tavolinë, projektligji për herë të parë parashikon që AKU, në raste të konstatuar ose të dyshimta për mospërputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe që shkaku mund të jetë kafsha e gjallë, për të vlerësuar shkaku të origjinës, mund të kryejë gjurmin në fermën e kafshëve të gjalla. Në këtë rast, shërbimi veterinar rajonal mbështet AKU-në.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë konsumatorët, fermerët, bizneset blegtorale, stacionet veterinare, farmacitë veterinare.

Projektligji do të ketë efekte direkte në ruajtjen e shëndetit të konsumatorëve nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të sëmundjeve me karakter zoonotik, duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme shëndetin e kafshëve dhe të ushqimeve me origjinë shtazore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështetet kjo ndërhyrje, objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Asyeja që qeveria ka vendosur të ndërhyjë është ruajtja e shëndetit të popullatës nga sëmundjet me karakter zoonotik që transmetohen tek njerëzit nga kafshët e prekura nga këto sëmundje, si dhe nëpërmjet ushqimeve të kontaminuara me shkaktarët zoonotikë, duke eliminuar të gjitha të metat dhe mangësitë e verejtura nga ligji i mëparshëm.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*

- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje qeveria synon të arrijë:

- Unifikimi i shërbimit veterinar brenda vitit 2021, që lidhet me një organizim të mirë të shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies.
- Garantimi i gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore nëpërmjet identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale dhe tufave bazë nga viti 2022.
- Garantimi i mbrojtjes së shëndetit të kafshëve nga sëmundjet me karakter zoonotik nëpërmjet kryerjes në mënyre efikase të masave të profilaksisë specifike.
- Garantimi i sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga kontrolli korrekt dhe me përgjegjësi të lartë të therjeve të kafshëve në thertore.
- Regjistrimin e të gjitha llojeve të kafshëve që mbarështohen në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim planifikimin korrekt të masave profilaktike.
- Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve nëpërmjet disiplinimit të lëvizjeve të kafshëve në territorin e vendit.
- Lehtësimi i biznesit nga procedura të panevojshme burokratike duke përmirësuar praktikën për regjistrimin e PMV-ve.
- Garantimi i një niveli më të lartë të sigurisë ushqimore nëpërmjet monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe mjedis.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës që është kryer nga MBZHR, janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

- Opsioni i status quo-së (0):

Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, së bashku me paketën nënligjore, në shumë raste ka lënë hapësira për abuzime sidomos në masat e profilaksisë veterinarë që mbështeten nga shteti ndaj sëmundjeve me karakter zoonotik, si edhe të masave gjurmuese ndaj këtyre sëmundjeve. Kjo për arsye të delegimit të këtyre veprimtarive tek stacionet private veterinarë për shkak të strukturës së papërshtatshme të shërbimit veterinar shtetëror. Kjo ka bërë që mangësitë të kenë qenë edhe në kontrollin e kafshëve të gjalla para dhe pas therjes në thertore si dhe në lëvizjen e kafshëve, të cilat shpesh janë bërë shkak për shpërthimin e zonave. Po ashtu regjistrimi dhe çregjistrimi i kafshëve është kryer në mënyrë jo të përshtatshme.

Boshllëku apo mbivendosja e institucioneve dhe si pasojë moszbatimi i plotë i dispozitave të ligjit ekzistues, për shkak të ndryshimeve dhe reformave të zbatuara vitet e fundit, ka bërë që ne disa raste, të mos të ketë ndarje të qarta të përgjegjësi dhe kompetencave për

menaxhimin, monitorimin, dhe kryerjen me efikasitet të të gjithë veprimtarisë së shërbimeve veterinarë rajonale.

- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Problemet e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues mbi Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me ruajtjen e shëndetit të popullatës nga sëmundjet me karakter zoonotik që transmetohen tek njerëzit nga kafshët e prekura nga këto sëmundje, si dhe nëpërmjet ushqimeve të kontaminuara me shkaktarët zoonotike duhet adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni i preferuar është amendimi i ligjit “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët bazuar në analizën e kryer në lidhje me garantimin e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve si dhe mbrojtjen e mjedisit.

- Opsioni 2: Ligj i ri për shërbimin veterinar

Hartimi i një ligji të ri për shërbimin veterinar do të sillte kosto më të lartë dhe zgjatjen e procedurave, për hartimin dhe miratimin e tij, si dhe do të prekte edhe çështje që nuk është e nevojshme të ndërhyet në këtë moment. Duke qenë se problematikat zgjidhen me ndryshimet në ligjin aktual del i panevojshëm hartimi i një ligji të ri.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*

- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

- *Grupet që preken janë:*

- Fermerët që merren me mbarështimin e kafshëve;
- Konsumatorët;
- Bizneset që merren me importet/eksportet e kafshëve;
- Stacionet veterinare;
- Farmacitë veterinare.

- ***Ndikimet ekonomike***

Ndikimi është i drejtpërdrejtë tek subjektet e mbarështimit të kafshëve, sepse me kryerjen korrekte të masave të profilaksisë veterinare, lëvizjes së kafshëve, zbatimit të biosigurisë në fermë si dhe standardeve të mirëqenies së kafshëve do të ketë ulje të dëmtimeve të kafshëve dhe shtim të prodhimit të tyre, e cila do të ndikojë direkt në financat e këtyre subjekteve. Nga ana tjetër ndikim të drejtpërdrejtë do të kenë edhe bizneset që merren me import/eksportin e kafshëve si rezultat i kontrollit të lëvizjes së kafshëve, do të ulet ndjeshëm përhapja e sëmundjeve infektive dhe zoonotike duke sjellë uljen e dëmtimeve në kafshë. Nga ana tjetër zbatimi i të gjitha këtyre masave do rrisë standardet dhe besueshmërinë e partnerëve ndërkombëtar për hapjen dhe rritjen e eksporteve të kafshëve të gjalla. Në të gjitha rastet përkthehet në shtim të të ardhurave. Edhe tek konsumatori ndikimi është i drejtpërdrejtë për shkak të aplikimit të masave për çrrënjosjen e sëmundjeve zoonotike që do të çojë në uljen e sëmundshmërisë dhe rritjes së aftësisë për punë. Ulja e sëmundshmërisë dhe rritja e aftësisë për punë bën që të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë financiar në shtim të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit nga ulja e buxhetit për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

- ***Ndikimet mjedisore***

Zbatimi me efikasitet të lartë i masave të parashikuara në projektligjin e paraqitur, si dhe monitorimi i këtyre aktiviteteve ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet dhe shkarkimet. Aktivitetet e rritjes dhe mbarështimit të kafshëve apo të tregtimit me pakicë e shumicë të medikamenteve veterinare licencohen vetëm pasi të jenë pajisur me lejen e mjedisit.

- ***Ndikimet sociale***

Transferimi i funksioneve të shërbimit veterinar nga pushteti vendor në shërbimin veterinar rajonal kërkon shtimin e numrit të veterinerëve zyrtar. Për përmbushjen e kësaj politike të re, për të afruar shërbimin veterinar sa më pranë fermerit dhe duke rritur garancinë për ushqim të sigurtë si rezultat i kafshëve të shëndetshme, do të punësohen rreth 400 veterinerë. Zbatimi me korektësi i masave profilaktike shtetërore do të ndikojë në rritjen e numrit të krerëve të bagëtive dhe në rritjen e produkteve blegtorale duke pasur një impakt pozitiv në ritjen e të ardhurave të tyre.

- *Ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

- **Ndikimet ekonomike**

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike*, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejtë në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e mbarështimit dhe tregtimit të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore si rezultat i forcimit të kontrollit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore të cilat kanë një risk të lartë në shëndetin e njeriut, e si pasojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor, reduktohen. Nga ana tjetër, reduktimi i transmetimit të sëmundjeve si rezultat i rritjes së kontrollit të lëvizjes së kafshëve, rritjes së biosigurisë në fermë dhe tregtimit të kafshëve në tregje të miratuara dhe kontrolluara reduktojnë shpenzimet për mjekimin e kafshëve si dhe dëmin ekonomik për subjektet të shkaktuar nga ngordhja e tyre.

Ndikimet sociale

Pavarësisht ndërhyrjes së drejtpërdrejtë tek konsumatori në lidhje me mbrojtjen nga sëmundjet zoonotike, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, projektligji ka ndikim tek konsumatorët, duke sjellë prodhime të sigurta dhe me një cilësi dhe gjurmueshmëri më të lartë. Rritja e sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore do të ndikojë në rritjen e shkallës së besueshmërisë të konsumatori.

- *Kufizimin e analizës:*

I gjithë shërbimi veterinar shtetëror, i parashikuar në projektligjin e paraqitur, i cili parashikon një shtim të numrit të veterinerëve, me rreth 400 persona, do të financohet nga buxheti i shtetit. Një pjesë do mbulohet nga puna veterinare që sot i jepet stacioneve veterinare pjesa tjetër do jetë me ndikim në buxhetin e shtetit.

Nga evidentimi që i është bërë veterinerëve në të gjithë vendin rezulton se një numër i të diplomuarve në veterinari punojnë jashtë fushës së edukimit të tyre dhe ngelet risk ofrimi i tyre në shërbimin veterinar rajonal e kryesisht për në zonat e thella malore.

Në raste të veçanta, p.sh, në raste të epidemive, të cilat mund të shoqërohen me therje masive të kafshëve, fatura financiare do të shtohet nga dëmshpërbilimi i kafshëve të theruara apo të eliminuara.

- *Vlerësimi i opsioneve:*

Opsionet e vlerësuara nga grupi i punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen për të arritur qëllimet/objektivat e këtij projektligji. Krahësimi është bërë duke u nisur nga numri total i neneve të projektligjit ekzistues dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen. Në përfundim u arrit në konkluzionin që paraqitja e projektligjit të jetë në formën e ndryshimeve në ligjin aktual.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është kryerja e ndryshimeve në Ligjin aktual nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në analizën me shumë kritere.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- Opsioni 0 (status quo): nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.
- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 10465, datë 29.9..2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
- Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi i kritereve që tregojnë arritjen e objektivit për të garantuar shëndetin e njerëzve nga rritja e sigurisë ushqimore si rezultat i kafshëve të shëndetshme:

- Efektiviteti në realizimin 100% të programeve të çrrënjësjes së sëmundjeve zoonotike në kafshë.
- Efektiviteti i kontrollit të lëvizjes dhe therjeve të kafshëve.
- Efektiviteti i identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale dhe kafshëve.
- Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore si rrjedhojë e zoonozave.
- Kostot.

2. Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative

- Efektiviteti në realizimin 100% të programeve të çrrënjësjes së sëmundjeve zoonotike në kafshë: 5;
- Efektiviteti i kontrollit të lëvizjes dhe therjeve të kafshëve: 3;
- Efektiviteti i identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale dhe kafshëve: 4;

- Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore si rrjedhojë e zoonozave: 5;
- Kostot: 5.

3. Përcaktimi i **shkallës së performancës** nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 5.

4. **Vendosja e pikëve të opsioneve** përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhteme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të programeve të çrrënjësjes së sëmundjeve zoonotike në kafshë	5	0	0	5	25	2	10
Efektiviteti i kontrollit të lëvizjes dhe therjeve të kafshëve	3	0	0	3	9	1	3
Efektiviteti i identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale dhe kafshëve	4	1	4	4	16	2	8
Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore si rrjedhojë e zoonozave	5	5	25	1	5	5	25
Kostot	5	0	0	4	20	5	25
Pikët totale për secilin opsion			29		75		71

Analiza me shumë kriterë tregon se opsioni 1 (ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me institucionet e saj të varësisë është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit, pas miratimit të këtij propozimi.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar për të arritur qëllimet e politikës institucionet përgjegjëse do të jenë:

- Drejtoria përgjegjëse në ministri që mbulon shërbimin veterinar, për zbatimin e programeve, si dhe;
- Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar, në katër rajone.

Nuk mund të konstatojmë aktualisht ndonjë pengesë në zbatimin e hartimit dhe miratimit të ligjit.

Për zbatimin e ligjit dhe përputhshmërinë me kërkesat e tij do të ndërmerren hapat e mëposhtme:

- o Do të fillojë një fushatë informuese për ndryshimet e paraqitura në projektligj;
- o Do të hartohen aktet nënligjore që rrjedhin prej këtij ligji;
- o Do të kryhet kualifikimi i strukturave zbatuese të ligjit dhe akteve të tij nënligjore.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Propozimi i këtij projektligji përmban elementë të rëndësishëm, për zbatimin e planit të punës, për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivit janë si më poshtë:

- Shkalla e perceptimit të konsumatorit në lidhje me sigurinë e produkteve ushqimore që konsumojnë;
- Realizimi i programeve kombëtare për çrrënjosjen e sëmundjeve zoonotike;
- Hartimi i legjislacionit në fushën e shërbimit veterinar në përputhje me Kapitullin 12 të Acquis;
- Monitorimi i sistemit të identifikim regjistrimit të fermave blegtorale dhe kafshëve të gjalla.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Opsioni 1

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
--	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	---------

Faktori zbritës	<u>1</u>	<u>0.952835</u>	<u>0.90789</u>	<u>0.86573</u>	<u>0.82427</u>	<u>0.78539</u>	<u>0.74835</u>	<u>0.71305</u>	<u>0.64942</u>	<u>0.647378</u>
			<u>4</u>		<u>1</u>	<u>4</u>	<u>1</u>	<u>5</u>	<u>3</u>	
Kosto për buxhetin – njëherë	48,800									
Kosto për buxhetin – në vazhdim	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	358,745	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	358,745	295,326	281,397	268,125	255,479	243,429	231,948	221,008	210,584	200,652
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total	2,566,692									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) =Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	2,566,692									

Opsioni 2

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	<u>1</u>	<u>0.952835</u>	<u>0.90789</u>	<u>0.86573</u>	<u>0.82427</u>	<u>0.78539</u>	<u>0.74835</u>	<u>0.71305</u>	<u>0.64942</u>	<u>0.647378</u>
			<u>4</u>		<u>1</u>	<u>4</u>	<u>1</u>	<u>5</u>	<u>3</u>	
Kosto për buxhetin – njëherë	1,308,800									
Kosto për buxhetin – në vazhdim	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	1,618,745	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945	309,945
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	1,618,745	295,326	281,397	268,125	255,479	243,429	231,948	221,008	210,584	200,652
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në										

vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	3,826,692									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) =Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	3,826,692									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milion lekë		Vlera aktuale neto në milion lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	2,566,692	0	2,566,692
Opsioni 2	3,826,692	0	3,826,692

Vlerësimi referuar opsionit 2, është gjykuar pas ndryshimeve sipas opsionit të zgjedhur, procesi përcillet me përfitime për buxhetin e shtetit në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa opsioni 1 është i shoqëruar me përfitime më të ulëta, pra VAN më e vogël.

Grupi i punës dhe RIA: